Procesverbal

nga Kuvendi i Punës - i FSSHK-së

Mbajtur në Sllatinë më 11.09.2026

KUVENDI I PUNËS

Rendi i ditës:

1. Verifikimi i mandateve të delegatëve
2. Zgjedhja e procesmbajtësit
3. Miratimi i rendit të ditës
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit të Kuvendit të datës 26.12.2025
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i raportit të punës për periudhën Janar - Dhjetor 2025
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i raportit financiar për periudhën Janar - Dhjetor 2025
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i raportit të Auditorit për periudhën Janar - Dhjetor 2025
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i raportit të Këshillit Mbikëqyrës.
9. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit financiar për vitin 2027
10. Të ndryshme

- Mbledhjen e hapi kryetari i Federatës së Sportit Shkollor z.Adrian Telaku i cili i përshëndeti delegatët e pranishëm në këtë kuvend, gjithashtu edhe mysafirët prezent z.Fikret Shatri nga MSR-ja dhe z.Gazmend Maxhuni nënkryetarin e Komitetit Olimpik.
  Fikret Shatri.- në fjalën e tij i përshëndeti të pranishmit, tha që është kënaqësi me qenë në mesin e juaj, theksoj se do të jetë një vit i vështir dhe me probleme, për shkak të ndarjes së ministrisë, por tha se pavarësisht nga kjo programet që janë të parapara është dhënë drita e gjelbër dhe disponimi është pozitiv për vazhdimin e tyre.
  Ai tha se Federata e Sportit Shkollor e ka marr primatin dhe besimin për punën e mirë dhe rezultatet e treguara viteve të fundit, që me parë as që janë mëndu.
  Në fund të fjalës së tij të gjithë të pranishmëve ju uroj fillimin e vitit të ri shkollor dhe suksese në angazhimet e tyre në bazë të kalendarit të garave, kurse kuvendit i dëshiroj punë të mbarë dhe suksese në vazhdimësi.
  Gazmend Maxhuni.- nënkryetari i Komitetit Olimpik në fjalën e tij në lidhje direkte telefonike e përshëndeti kryetarin e FSSHK-së, përfaqësuesin e MSR-së, anëtarët e Bordit të Federatës dhe të gjithë kuvendarët, iu uroj suksese në këtë kuvend të punës dhe falënderoj anëtarët e federatës për punën e mirë që po e bëjnë, dhe tha se do të jem në kontakt më z. Shatri për marrjen e informatave shtesë për mbarëvajtjen e këtij kuvendi.

-I-

Kryetari kërkoj tri propozime për komisionin për verifikimin e mandateve ku nga delegatët prezent u propozuan këta tre anëtarë:

- Egzon Nezaj
- Burim Berisha
- Hamit Guri

- Komisioni për verifikimin e mandateve pas verifikimit të listës dhe autorizimeve të delegatëve prezent konstaton se nga 21 delegatë me të drejt vote, prezent janë 19 prej tyre. Komisioni konstaton se janë plotësuar të gjitha kushtet dhe se Kuvendi mund ta fillojë punën.

-II-

Zgjedhja e procesmbajtësit, ishte pika e dytë e rendit të ditës, dhe si zakonisht të gjithë të pranishmit u dakorduan që mbajtës i procesverbalit të jetë sekretari teknik i federatës Leonard Cula.

-III-

- Më pas kryetari e propozoj rendin e ditës i cili u aprovua nga të gjithë të pranishmit.

-IV-

Në pikën e katërt të rendit të ditës ishte Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit të Kuvendit të kaluar të mbajtur më datë 26.12.2025, materiali ishte shpërndarë me kohë dhe se nuk kishte asnjë vërejtje. **Aprovohet Procesverbali pa vërejtje**.

-V-

Pika e radhës ishte Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit të Punës për periudhën Janar-Dhjetor 2025 Kryetari në pika të shkurta foli për punën e bërë për këtë periudhë, garat shkollore, angazhimet e mëdha me dy projektet shtetërore Drejt Malit – Hiking dhe Skijim, për programin “Sport në Shkolla” si dhe për organizimin e gjimnaziadës në Pejë. dhe e hapi diskutimin për raportin e punës.

Pasi nuk kishte asnjë diskutim tjetër nga të pranishmit, kryetari kërkoj ta aprovojmë edhe raportin e punës. **Aprovohet Raporti i punës nga të gjithë pranishmit.**

-VI-

Në rend dite ishte shqyrtimi dhe aprovimi i raportit financiar, ku kryetari z.Telaku foli për procesin e përpilimit të raportit, shpenzimet që janë bërë për këtë periudhë. Kërkoj nga të pranishmit nëse kanë ndonjë vërejtje apo ndonjë informatë që ju intereson rreth shpenzimeve të buxhetit, jam i gatshëm t'ju shpjegoj deri ne detale çdo shpenzim. Pasi raporti nuk patë asnjë vërejtje.
Aprovohet Raporti Financiar nga të gjithë të pranishmit.

-VII-

Kjo pikë e rendit të ditës ka të bëj me raportin e Auditorit, i cili e ka cilësuar si raport të rregullt të Auditimit dhe nuk ka pasur vërejtje, në të kundërtën kur ka vërejtje Auditori raportin e shpallë të kualifikuar e që në këtë rast çdo shpenzim është dokumentuar dhe faktuar në rregull. Zakonisht raporti i Auditorit nuk debatohet dhe kryetari e qiti në aprovim. **Aprovohet Raporti i Auditorit nga të gjithë të pranishmit.**

-VIII-

Pika e tetë i takon Raportit të Këshillit Mbikëqyrës, i cili konstaton se ka pasur bashkëpunim shumë të mirë me organet e federatës, dhe se kanë pasur në dispozicion të gjithë materialin e kërkuar, dhe se raporti i shpenzimeve të federatës është në përputhje të plot me raportin e Auditorit. **Aprovohet raporti i Këshillit mbikëqyrës pa asnjë vërejtje**

-IX-

Pika e nëntë e rendit të ditës ishte prezantimi i planit financiar për vitin 2027, ku kryetari foli për të gjitha projektet e planifikuara, por edhe për garat ndërkombëtare ku shpenzimet janë shumë të larta për pjesëmarrje dhe se konkurrenca është shumë e fort dhe jo e barabartë në këto gara dhe nuk ja vlen të marrim pjesë. Foli edhe për takimet që ka pasur me ministrin e Sportit, dhe se gjendja aktuale politike ka bërë që programet planifikojnë të fillojnë nga muaji janar.

Fatmir Ademaj.- kërkoj informata rrethe tërheqjes së disa shkollave nga programi "Sport në Shkolla", a ka qenë pagesa e vogël shkak për tërheqje dhe të shikohet mundësia që të rritet kjo pagesë për mësimdhënësit.

Dren Marseli.- tha se vetën në komunën e Prishtinës janë tërhequr tri shkolla (hendboll) me marrëveshje në mes veti për shkak të pagesës së vogël, gjithashtu theksoj se edhe në planin financiar për vitin 2027 kanë bërë kërkesë për rritjen e pagesës së mësimdhënësve të angazhuar në program, por kjo mbetet të shihet në vazhdim gjatë takimeve të radhës me përfaqësuesit e ministrisë.

Adrian Telaku.- tha se do ta bëjmë planifikimin e ri në bazë të rezultateve nga tereni, ku pjesëmarrëse do të jenë gjithsej 105 shkolla, kurse sipas planifikimit paga neto për mësimdhënës do të jetë 160 euro, nëse një mësimdhënës i ka dy grupe të nxënësve gjithsejtë i ka 16 treningje që çmimi për një trening do të jetë 10 euro.

Arbisa Shefkiu.- theksoj se është takuar edhe me Institutin Pedagogjik dhe se diskutim kryesor ka qenë edhe avancimi i mësimdhënësve, ku do të ketë edhe trajnime të akredituara nga MASHT që ju nevojiten mësimdhënësve për licencim ose rilicencim.

Aprovohet Plani financiar për vitin 2027 pa asnjë vërejtje

-X-

Fikret Shatri.- theksoj se arsyeja pse po kalojnë pikat pa ndonjë debat është se kjo federatë është unike dhe e decentralizuar, sepse çdo program e çdo aktivitet shoqatat nëpër teren janë bartëse të aktiviteteve, pra për këtë arsye mungon debati. Vërejtja e vetme ishte te pagesat e ulëta të mësimdhënësve, tha që është diskutua edhe ky problem, por këto ishin mundësitë e ministrisë.

Fatmir Ademaj.- falënderoj federatën për përkrahjen që ju kanë dhënë shoqatave me pajisje të ndryshme, u diskutua edhe disa probleme teknike të regjionit të Pejës si mungesa e informatave për gara dhe zgjedhja e përfaqësuesit të regjionit të Pejës, ku paraprakisht ish dashtë të takohemi ne kryetarët e shoqatave e të vendosim.

Adrian Telaku.- është shumë e vërtet se kuvendi po kalon në këtë formë pa ndonjë diskutim, për arsye se ju jeni ata bartës të të gjitha aktiviteteve.

Fikret Shatri.- foli për regjionin e Pejës e konkretisht për Istogun, ku kërkoj të dominoj bashkëpunimi më i mirë në mes të kolegëve e mos të dominoj egoja personale te na. Sporti shkollor Pejë, nga një shoqatë inegzistente, ka kalu në një nivel shumë të lart të organizimit, ku që dy vite ka organizua edhe gjimnaziadën që d.m.th është ngrit niveli i punëve, e për kolegët nga Istogu kërkoj bashkëpunim më të mirë dhe të vlerësohet puna e njëri tjetrit sepse nëse ne si kemi raportet e mira, këtu pësojnë vetëm fëmijët.

Agron Dubovci.- kërkoj që çështjet ose problemet që i kanë regjionet duhet ti zgjidhen brenda regjionit dhe se ato mos të bartën te kuvendi i federatës.

Albert Husaj.- pas ankesës së shoqatës nga Istogu për mungesë të informatave, tha se nuk ka munguar asnjëherë informata dhe se sporti shkollor Istog ka marr pjesë në të gjitha garat e parapara me kalendarin e garave.

Fatmir Ademaj.- vetëm kam kërkuar ta kemi informatën kur të zgjidhet përfaqësuesi i regjionit, dhe se nuk kemi asgjë kundër njëri tjetrit, dhe nëse ka mundësi te pagesa të përshkruhet qëllimi i pagesës.

Burim Berisha.- kërkoj që pagesa e mëditjeve të mësimdhënësve të jetë 30 euro neto dhe se tatimin ta paguaj federata.

Basri Jashari.- tha se disa regjione të vogla ku kemi më pak ndeshje problem është edhe pagesa e mjekut, për 3-4 ndeshje, mjeku duhet të qëndroj gjatë dhe për atë pagesë të vogël po është problem mi sigurua shërbimet e tij.

Arbisa Shefkiu.- tha se si pjesë e programit "Sport në Çerdhe" ka qenë aktiviteti më atraktiv ku kanë marrë pjesë 336 fëmijë, dhe se kjo pjesë ka qenë pjesa më e mirë e programit.

Adrian Telaku.- ju përgjigj disa pyetje lidhur me shumën e pagesave dhe pagesat për mjekët. Sa i përket shumës së mëditjeve tha se ekziston një rregullore e MSR-së, ku memorandumi e parasheh që nuk guxon të tejkalohet 25% e shumë për paga e mëditje, kurse sa i përket pjesëmarrjes së mjekëve në gara, jemi në pritje të hyrjes në fuqi të legjislacionit ku shoqatat vetëm duhet ta bëjnë kërkesën në QKMF-të komunale dhe ato janë të obliguara për ti mbuluar të gjitha aktivitetet, sepse i obligon qarkorja që e ka bërë Ministria e Arsimit.

Në fund kryetari i falënderoj të gjithë të pranishmit për kohen dhe kontributin e tyre gjatë këtij kuvendi.

Kuvendi përfundoj në ora 18:30

Kryetari i FSSHRK-së
Adrian TELAKU

FEDERATA E SPORTIT SHKOLLOR REPUBLIKA E KOSOVËS
FSSHRK
REPUBLIC OF KOSOVA SCHOOL SPORTS FEDERATION

Procesmbajtës:
Leonard CULA